1591
27.11.2020

(3)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.5602/1 Prot. **Elbasan, më 27.11.2020.**

# V E N D I M

**Nr. 149 Datë: 27.11.2020.**

*"Mbi miratimin në parim për dhënien me enfiteoze të pasurisë "Thertorja Publike Elbasan", ndodhur në Z.K. 8522"".*

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.11.2020 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë bazuar në ligjin Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*; ligjin Nr. 115/2014 *"Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërise"*, i ndryshuar,; Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë 11.07.2007 *"Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit"*; V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore"*;

**V E N D O S I :**

1. Miraton dhënien me enfiteozë të pasurisë në pronësi të Bashkisë Elbasan me nr. 14/32 "Thërtorja Publike Elbasan", me sipëfaqe 250 $m^2$ "truall + ndërtesë", ndodhur në Lagjen "Hekurudha", Z.K. 8522, sipas proçedurave ligjore të përcaktuar në V.K.M Nr. 54, datë 05.02.2014.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**
**Hektor Çiftja**

1592
27.11.2020

7 (33)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 5603/1 Prot.** **Elbasan më 27.11.2020**

**VENDIM**

**Nr. 150 datë 27.11.2020**

***"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit,***

***zotit Tritan Kalo"***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.11.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) *"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit, zotit Tritan Kalo",* mbështetur në nenin 54 (gërma "m") të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma "a" dhe pika 2, gërma "b") të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. T'i japë titullin "Qytetar Nderi" i Elbasanit, zotit Tritan Kalo, me motivacionin:

   **"Për kontributin e dhënë në fushën e mjekësisë dhe mësimdhënies, si specialist i sëmundjeve infektive dhe tropikale, duke treguar profesionalizëm, përkushtim dhe humanizëm në përballjen me sëmundjet infektive, sidomos gjatë pandemisë shkaktuar nga COVID-19, duke vënë në rrezik jetën për të shpëtuar jetët e të tjerëve".**

2 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI** **KRYETARI**

**Klajd Gripshi** **Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

5603/2
dt. 07.12.2020

(34)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

Nr. 1592/1 prot. Elbasan, më 2.12.2020

**Lënda:** *Konfirmim Akti*

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.150 datë 27.11.2020, "Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" i Elbasanit, Z.Tritan Kalo", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Klevis XHOXHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Adresa: Lagjia "Brig.17 Sulmuese", Rruga "Q.Stafa", Tel: 054 252138, www.prefektielbasan.gov.al, prefekti.elbasan@mb.gov.al

7/1

(11)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.** 5604/1 **Prot.** **Elbasan më** 27 **.11.2020**

**VENDIM**

**Nr.** 151 **datë** 27 **.11.2020**

***"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Elbasanit,***

***zotit Ilo Shqau"***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.11.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) *"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Ilo Shqau"*, mbështetur në nenin 54 (gërma "m") të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma "a" dhe pika 2, gërma "b") të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. T'i japë titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Ilo Shqau, me motivacionin:

   **"Për kontributin e dhënë, si inxhinier i përpunimit të drurit, me inovacione në punën e tij 40 vjeçare (teorike dhe praktike) në Kombinatin e Drurit Elbasan, ku ai punoi".**

2 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI** **KRYETARI**

**Klajd Gripshi** **Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5606/1 Prot. Datë 27.11. 2020

# VENDIM

## NR. 152 DATË 27. 11. 2020

## PËR

***"Miratim i marrëveshjes së financimit midis GIZ dhe Bashkisë Elbasan për realizimin e projektit "Promovimi i punësimit të të kthyerve përmes punëve të komunitetit në Bashkinë Elbasan", "Programi GIZ për Migrim dhe Zhvillim".***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.11. 2020, pasi shqyrtoi marrëveshjen e bashkëpunimit me GIZ për realizimin e projektit *"Promovimi i punësimit të të kthyerve përmes punëve të komunitetit në Bashkinë Elbasan", Programi GIZ për Migrim dhe Zhvillim"*, propozuar nga Kryetari i Bashkisë, mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
b) Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSh" (i ndryshuar);
c) Ligjin nr.10296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar);
d) Ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet", (i ndryshuar);
e) VKM nr.717, datë 23.06.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar;
f) Udhëzimin e MF nr.9 datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit";

## VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen e financimit midis GIZ dhe Bashkisë Elbasan *"Promovimi i punësimit të të kthyerve përmes punëve të komunitetit në Bashkinë Elbasan"*, në kuadër të projektit "Programi GIZ për Migrim dhe Zhvillim", financuar nga Qeveria Gjermane, Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. ( bashkëlidhur marrëveshja)

2. Të miratojë rritjen e numrit të punonjësve sezonale për ASHP, me afat 2(dy) muaj përgjatë periudhës 15 nëntor 2020 deri me 31 mars 2021, financuar nga projekti "Programi GIZ për Migrim dhe Zhvillim", tabela "Buxheti i detajuar", gjithsej 94 (nëntëdhjetëekatër) :

- punëtor mirëmbajtës, klasa IV, paga baze mujore 33,400 lekë, punonjës 90 (nëntëdhjetë);
- supervizor (përgjegjës sektori), klasa XI, paga bazë mujore 37,000 lekë, punonjës 4 (katër);

Diferencat e fondit për shtesën e vjetërsisë mbi pagë do të kompesohen nga fondi i pagave miratuar në buxhet për ASHP.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit dhe ASHP.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETAR**
**Klajd Gripshi**

**KRYETAR**
**Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA ELBASAN

1583
27.11.2020

7/1
(11)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.** 5604/1 **Prot.** **Elbasan më** 27 **.11.2020**

**VENDIM**

**Nr.** 151 **datë** 27 **.11.2020**

***"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Elbasanit,***

***zotit Ilo Shqau"***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.11.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Arsimit Parashkollor, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Sportit (Sektori i Turizmit dhe i Trashëgimisë Kulturore) *"Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Ilo Shqau"*, mbështetur në nenin 54 (gërma "m") të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërma "a" dhe pika 2, gërma "b") të ligjit nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. T'i japë titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Elbasanit, zotit Ilo Shqau, me motivacionin:

   **"Për kontributin e dhënë, si inxhinier i përpunimit të drurit, me inovacione në punën e tij 40 vjeçare (teorike dhe praktike) në Kombinatin e Drurit Elbasan, ku ai punoi".**

2 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI** **KRYETARI**

**Klajd Gripshi** **Hektor Çiftja**

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q. Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

3812
d. 03.10.08

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "11Nëntori",Tel:003555453328 Fax:003555452246, e-mail:Bashkia elbasan@yahoo.com

Nr.382.prot

Elbasan 02.10.2008

# VENDIM

Nr.92.datë 29.09.2008

*"Mbi miratimin e listës së emrave, që do të emërtohen rrugët dhe rrugicat pa emër të qytetit të Elbasanit"*

Këshilli Bashkiak i Qytetit të Elbasanit, i mbledhur sot më datë 29.09.2008, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës: "Mbi miratimin e listës së emrave, që do të emërtohen rrugët dhe rrugicat pa emër të qytetit të Elbasanit", duke u mbështetur në projektim LAMP dhe në ligjin nr.9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e Adresave", i ndryshuar; VKM nr.446, datë 05.03.2008 "Për përcaktimin e specifikimeve teknike të tabelave të emërtimeve të parqeve, shesheve, bulevardeve e rrugëve dhe të numërtimit të ndërtesave"; Urdhërit të Ministrit të Brendshëm, nr.4080, datë 28.08.2008, për miratimin e Rregullores "Për rregullat e punës në hartë për adresimin e pjesëve të territorit publik nga bashkitë/komunat"; të VKM nr.332, datë 12.03.2008 "Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik ajror, digjital, i territorit të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32,

**VENDOSI**

1. Të miratojë listën e emrave (bashkalidhur) për emërtimin e rrugëve/rrugicave pa emër të qytetit të Elbasanit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Urbanistik të Territorit
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**SEKRETARI**

**Reshit Haxhihyseni**

**KRYETARI**

**Bujar KLLOGJRI**

1601
27.11.2020

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# BASHKIA ELBASAN
# KËSHILLI BASHKIAK

**Nr. 5613/1 Prot.** **Elbasan më, 27.11.2020**

## VENDIM

**Nr. 160 Datë: 27.11.2020**

**"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga shpërthimi i bombulës së gazit në banesën e Z. Ruzhdi Shaqir Ago, banor në Fshatin Katund i Ri, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar".**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.____.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Ruzhdi Shaqir Ago,** banor në Fshatin Katund i Ri, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan si dhe dëmshpërblimin financiar", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

## VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga shpërthimi i bombulës së gazit në banesën e shtetasit **Z. Ruzhdi Shaqir Ago,** e cila është në masën **1 107 735** ( një milion e një qind e shtatë mijë e shtatë qind e tridhjetë dhjetë e pesë ) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **2 029 471 x 50% = 1 014 735 lekë + 93 000 lekë = 1 107 735 lekë**.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **1 107 735** ( një milion e një qind e shtatë mijë e shtatë qind e tridhjetë dhjetë e pesë ) **lekë,** për familjen e **Z. Ruzhdi Shaqir Ago.**

4. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 252. datë 24.12.2019.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore ( Drejtoria e Emergjencave Civile ).
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**

**Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN -

16 02
27.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

**Nr.** 5614/1 **Prot.**

**Elbasan më** 27.11**.2020**

**VENDIM**

**Nr.** 161 **Datë:** 27.11**.2020**

**"Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z.Artam Themi Mëhillka, banor në Lagjen "Haxhias", Lagjja Nr. 5, Elbasan si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan"**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___.___.2020, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës "Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së shtetasit **Z. Artam Themi Mëhillka,** banor në Lagjen "Haxhias", Lagjja Nr. 5, Elbasan_si dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile";
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";
- VKB Nr. 252. datë 24.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020";

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Elbasan.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e shtetasit **Z. Artam Themi Mëhillka,** e cila është në masën **62 592** (gjashtëdhjetë e dy mijë e pesë qind e nëntëdhjetë e dy ) **lekë**. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët + vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi, d.m.th. **125 184 x 50% = 62 592 lekë.**
3. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **62 592** (gjashtëdhjetë e dy mijë e pesë qind e nëntëdhjetë e dy ) **lekë,** për familjen e **Z.Artam Themi Mëhillka.**

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

4. Efekti financiar, për pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet nga Fondi i Emergjencave Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 252. datë 24.12.2019.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore ( Drejtoria e Emergjencave Civile ).
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**

**Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

1604

27.11.2020

1215

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5616/1 Prot.

Elbasan, më 27.11.2020

**V E N D I M**

**Nr. 163 dt. 27.11 2020**

**PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM**
Për mbarështhimin e florës së egër, kultivimin e bimëve të ndryshme, zhvillimin e agropylltarisë dhe për qëllime pushimi e argëtimi, në ngastrat nr. 23ab, 24ab, 25a dhe 26b, në ekonominë pyjore "Zalli Shkumbin".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____.11.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit, mbështetur në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
- Ligjin nr 57/2020 datë 30.4.2020 "Për pyjet",
- Ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar,
- Ligjin nr. 8318, datë 1.4.1998 "Për dhënien me qera të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar (neni 13,16),
- VKM nr. KM 433 dt.8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", i ndrysuar me VKM nr. 684 dt. 2.9.2020.
- VKM nr.1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", të ndryshuar,
- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik",

***V e n d o s i:***

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim me qira, të fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Elbasan, për mbarështhimin e florës së egër, kultivimin e bimëve të ndryshme, zhvillimin e agropylltarisë dhe për qëllime pushimi e argëtimi, nëpërmjet procedurës të konkurimit publik, për sipërfaqet pyjore sipas listës bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjthshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Prokurimeve Publike dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit.

3. Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**
**Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA ELBASAN -